



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë më, 22.10.2018, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratim i procesverbaleve të datave 16.10.2018 dhe 17.10.2018.

2. Shqyrtim i Projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në Liqenin e Shkodrës”.

3. Shqyrtim i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit Europian për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit, mbi vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europol-it”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia. Luan Duzha, Luan Harusha, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Elona Hoxha, Anduel Xhindi dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Myslym Murrizi, Paulin Sterkaj Ervin Saliangji, Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunksi dhe Isuf Çelaj.

Të ftuar :

Rovena Voda - Zëvendësministre e Brendshme

Besfort Lamallari - Zëvendësministër i Brendshëm

Xhevahir Karaj - Drejtues i Parë, Drejtor i Drejtorisë së Kufirit, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin,

Shkëlzen Rexhepi – Kryekomisar, Shef i Zyrës Kombëtare të EUROPOL-it

Anisa Boçi - Specialiste në Drejtorinë Juridike, pranë Departamentit për Shërbimet Mbështetëse.

Jeton Xoxa - Specialist i Sektorit të Bashkëpunimit, Marrëveshjeve dhe Kontratave në Ministrinë e Brendshme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Sigurisë Kombëtare. Në rendin e mbledhjes së sotme kemi parashikuar miratimin e procesverbaleve të datave 16 dhe 17 tetor 2018.

Kolegë, a keni ndonjë vërejtje për procesverbalet e këtyre mbledhjeve?

Nuk ka.

Dy pikat e tjera të rendit të ditës për sot janë shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në Liqenin e Shkodrës”. Për këtë projekt është caktuar si relator nga ana e Komisionit të Sigurisë Kombëtare, zoti Luan Harusha.

Pika tjetër e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit Europian për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit mbi vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europol-it”. Për këtë projektligj nga Komisioni i Sigurisë Kombëtare është caktuar relator Xhemal Qefalia.

Të ftuar për prezantimin e dy projektligjeve, sipas rendit që lexova, janë: zonja Rovenë Voda, zëvendësministre e Brendshme, zoti Besfort Lamallari, zëvendësministër i Brendshëm, zoti Xhevahir Karaj, drejtues i parë, drejtor i Drejtorisë së Kufirit në Departamentin për Kufirin dhe Emigracionin dhe kryekomisar Shkëlzen Rexhepi, shef i Zyrës Kombëtare të EUROPOL-it. Besoj se me ju janë edhe dy specialistët, zonja Anisa Boci, specialiste në Drejtorinë Juridike pranë Departamentit për Shërbimet Mbështetëse dhe zoti Jeton Xoxa, specialist i Sektorit të Bashkëpunimit, Marrëveshjeve dhe Kontakteve në Ministrinë e Brendshme.

Faleminderit për prezencën tuaj!

Pa humbur kohë fillojmë me shqyrtimin e projektligjit për hapjen e pikës së re të kalimit kufitar, atë të Zogajt në qarkun e Shkodrës.

Kush nga zëvendësministrat do ta marrë fjalën?

Zonja Voda, fjala për ju.

Rovenë Voda – Faleminderit, zonja kryetare!

Jemi sot në këtë komision, siç e thatë edhe ju, për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në Liqenin e Shkodrës”.

Do të thoni ju, pse në këtë moment? Për këtë çështje do të doja t’ju jepja një shpjegim të shkurtër.

Me Malin e Zi është vënë re se vitin e fundit qarkullimi i pasagjerëve, por edhe i mallrave, ka ardhur gjithnjë në shtim. Kemi pasur një eksperiencë mjaft pozitive edhe me pikën e përbashkët të kalimit kufitar, ndoshta e para e hapur që nga viti 2008, atë të Murriqanit, me një ndalesë, një hyrje dhe një dalje, pikë e përbashkët, ku edhe impakti ka qenë shumë pozitiv, duke lehtësuar qarkullimin si të pasagjerëve edhe të mallrave.

Sigurisht, flukset kanë ardhur gjithnjë e në rritje. Kjo pikë do të jetë në anën e liqenit të Shkodrës. Në fakt, kjo është një kërkesë e banorëve shqiptarë që ndodhen në anën e Malësisë së Tivarit, pra në pjesën e Malit të Zi. Pasi u bë një vlerësim nga strukturat tona të Policisë Kufitare dhe të Migracionit u pa me vend, edhe për të përmirësuar dhe për të lehtësuar qarkullimin e pasagjerëve dhe të mallrave, por ndoshta kjo do të ndikonte edhe në zhvillimin e turizmit në zonën e liqenit të Shkodrës.

Këto kanë qenë arsyet që çuan në dakordësinë midis të dyja palëve, pra Malit të Zi dhe Shqipërisë, për hapjen e kësaj pike kufitare, e cila mendoj se do t’i shërbejë komunitetit shqiptar në të dyja anët e territorit. Sigurisht, janë bërë një sërë diskutimesh midis departamentit të kufirit dhe emigracionit të të dyja vendeve përkatëse, pra Policisë së Shtetit tonë dhe policisë së Malit të Zi, duke u dakordësuar.

Unë desha të shtoj se është parashikuar që implementimi i këtij projekti do të monitorohet edhe nga një komision dypalësh, i cili do të ketë në fokus implementimin e këtij projekti të pikës së përbashkët kufitare të Malit të Zi.

Sa u përket shpenzimeve buxhetore, ato do të parashikohen në zërin buxhetor të investimeve për Policinë së Shtetit.

Ermonela Felaj- Faleminderit, zonja Voda!

Fjala për ju zoti Harusha.

Luan Harusha- Faleminderit!

Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët kufitare Skie për qarkullimin ndërkombëtar rrugor të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës.

Në kufirin me Malin e Zi për lehtësimin e lëvizjes së lirë të shtetasve në zonën e Zogajve të Bashkisë Shkodër, është evidentuar që mund të hapet një vend kalim i ri për komunikimin ndërkombëtar tokësor dhe ujor. Vendi i quajtur Zogaj Shqipëri-Krajë Mali i Zi, është një pikë e përbashkët e kalimit kufitar në Bashkinë Shkodër, në kufirin me Malin e Zi, e cila ndodhet 11 kilometra në veriperëndim të qytetit të Shkodrës në bregun e quajtur liqeni i Shkodrës. Marrëveshja është iniciuar në kuadër të forcimit të bashkëpunimit midis dy shteteve për të krijuar kushte sa më të mira për zhvillimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi në kuadër të lehtësimit të qarkullimit në pikën e përbashkët kufitare duke marrë masa të përbashkëta.

Përparësitë që priten nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje lidhen me lehtësimin e lëvizjes së banorëve të Zogajve afër Bashkisë së Shkodër dhe të zonave të Malësisë së Krajës në komunën e Tivarit të Malit të Zi në të dyja anët e kufirit; shkurtimin e distancës së kontrollit më të mirë të sektorit të kufirit në zonën e Zogajve dhe kontrollin e liqenit të Shkodrës, si edhe shfrytëzimin e vlerave turistike në liqenin e Shkodrës dhe traditat e banorëve të Malësisë së Tivarit.

Palët do të marrin masa të përbashkëta dhe, sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje, do të konsultohen me njëra-tjetrën lidhur me problematikat që mund të lindin. Kostoja financiare, ashtu siç e tha zëvendësministrja, është e parashikuar në marrëveshje dhe do të përballohet nga programi buxhetor i Policisë së Shtetit. Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Atëherë, sipas Rregullores, kalojmë te pyetjet nga kolegët për përfaqësuesit e ministrisë apo edhe për relatorin.

Fjala është për zotin Ndreu.

Pjerin Ndreu – Faleminderit!

Natyrisht, hapja e pikës së kalimit kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi është një hap pozitiv, por unë dua të di: a keni bërë një matje të fluksit të kalimit të njerëzve? Çfarë mendoni për infrastrukturën rrugore, sepse ka një problematikë në infrastrukturë, por edhe godinat, pajisjet, mjetet e të tjerë? Pra, a keni rënë dakord edhe me palën tjetër që të investohet? Si është situata tani dhe çfarë perspektive ka ajo?

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ndreu!

Fjala është për zotin Karaj.

Xhevair Karaj- Faleminderit!

Është një pikë e përbashkët e kalimit kufitar, që është vendosur në bisedime të plota me policinë kufitare të Malit të Zi. Si fillim do t'u shërbejë rreth 1500 apo 2000 banorëve shqiptarë të Malit të Zi, që janë në krahinë e Krajës, dhe rreth 2000-2500 banorëve të fshatrave Shirokë dhe Zogaj. Ndërkohë, në momentin që kjo pikë kufitare do të funksionojnë si ndërkombëtare, normalisht që do të ketë një fluks shumë të madh të lëvizjeve se në fillimet e saj, ashtu siç ka qenë në fillim edhe pika kufitare e Muriqanit. Veçoria e kësaj pike kufitare është se do të jetë pika e vetme e përbashkët që do të shërbejë edhe për ujin, edhe për rrugën automobilistike. Ndërkohë, janë marrë të gjitha masat, në bashkëpunim të plotë, për ndërtimin e kësaj pike. Kjo pikë kufitare do të ndërtohet në pjesën e Malit të Zi dhe investimet pothuajse do të jenë të barabarta midis Policisë së Shtetit shqiptar dhe policisë së Malit të Zi. Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, relatori ka një pyetje.

Luan Harusha - Sa mund të zgjasë projekti për hapjen e pikës kufitare në atë zonë?
Faleminderit!

Xhevair Karaj - Kemi një periudhë kohore 10-vjeçare, që kërkohet nga komuniteti shqiptar i Malit të Zi. Pra, iniciativa ka qenë nga pala e Malit të Zi. Mendohet që brenda vitit 2019 do të fillojë edhe ndërtimi i kësaj pike, ndërsa përfundimet ende nuk janë vendosur. Pra, nuk kemi një vendim, por mendojmë se punimet do të përfundojnë brenda vitit 2019.

Ermonela Felaj - Për ta vijuar edhe njëherë pyetjen e kolegut, sepse besoj se marrëveshja që duhet të miratojmë sot në komision është një marrëveshje në parim. Pra, ju nuk keni hyrë në diskutime më të hollësishme lidhur me mënyrën se si do të funksionojë kjo pikë kufitare, si do të bëhet pajisja me infrastrukturë dhe logjistikë apo edhe rrugët që do të çojnë në përdorimin saj. Pra, a do të ketë ndërhyrje, sepse këtu flasim edhe për një përdorim rrugor? A do të jetë kjo rruga e përshtatshme, që të fillojë të përdoret si një pikë kalimi kufitar? Nga ana tjetër, në çfarë gjendje shfaqet pjesa që i takon lëvizjes nëpërmjet liqenit?

Xhevair Karaj - Për ndërtimin e kësaj pike kufitare janë bërë disa takime nga ekspertë të të dyja policive. Segmenti prej 2,5 kilometrash i rrugës së vjetër, 1 kilometër nga territori i tyre dhe 1,5 nga territori ynë, është parë i nevojshëm që të bëhet i ri. Pra, për ndërtimin e kësaj rruge

do të ketë nevojë edhe për investimet e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, të cilat do të llogariten edhe në projektligj. Ndërkohë, do të jetë një pikë kontrolli e kalimit që do të funksionojë si të gjitha pikat e tjera, nuk do të ketë ndonjë veçori.

Për sa i përket vendit ku do të vendosen mjetet lundruese, ne kemi vendosur që të jetë në anën e Malit të Zi, sepse moli është i përfunduar dhe do të llogaritet vetëm ndërtesa dhe rruga.

Ermonela Felaj – Zoti Sinaj, ka një pyetje për ju.

Vullnet Sinaj – Drejtuesi i kufirit tha që pika kufitare do të ndërtohet në pjesën e Malit të Zi, për çfarë arsye? A jemi të sigurt që ajo do të funksionojë? Çfarë marrëveshje kemi me Malin e Zi?

Xhevahir Karaj – Si përvojë kemi pikën e përbashkët të kufirit në Muriqan, e cila është në territorin tonë dhe funksionon shumë mirë në të dyja anët, është e njëjta gjë vetëm se pika do të jetë në territorin malazes, kjo për arsye se moli është i ndërtuar. Marrëveshja është e përfunduar dhe e miratuar në parim edhe nga VKM-ja në korrik, dokumentacioni është gati.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Duzha dhe pastaj zoti Braho.

Luan Duzha – Faleminderit, zonja kryetare!

A do të ketë përfaqësues nga dogana? Nëse po, a keni bërë rakordimin me drejtorinë e doganave?

Xhevahir Karaj – Pa diskutim që do të ketë përfaqësues nga dogana. Për këtë arsye e përmendëm edhe Ministrinë e Financave, sepse dogana mbulohet nga Ministria e Financave. Të gjitha shërbimet që janë në një pikë kontrollkalimi, do të jenë edhe aty.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Braho.

Spartak Braho – Dy qeveritë e kanë nënshkruar këtë marrëveshje në korrik të vitit 2018, ndërkohë që ne po e kalojmë për miratim në parlament. Po parlamenti malazes e ka miratuar?

Xhevahir Karaj – Parlamenti malazes nuk e ka miratuar. Por në momentin që këtu do të miratohet, ne do t'ua bëjmë të qartë që e miratuam.

Ermonela Felaj – A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Besoj se çështja është e qartë, me këtë marrëveshje palët kanë rënë dakord në parim për hapjen e një pike të re të kalimit kufitar. Nga pozitat e qytetarit të thjeshtë, mund ta kemi konstatuar që fundjavat në Malin e Zi janë shumë të ngarkuara për pikën e kalimit kufitar të Muriqanit, edhe

pse aty nga të dyja palët punohet me të gjitha kapacitetet, radhët tregojnë që është nevoja për një pikë tjetër. Prandaj, jo vetëm unë, por të gjithë kolegët e gjejnë më vend marrëveshjen për të hapur këtë pikë të re të kalimit kufitar.

Unë i ftoj kolegët ta votojnë këtë marrëveshje.

Kush është dakord në parim me projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj-Skje? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nën për nën të kësaj marrëveshjeje.

Neni 1.

Kush është dakord me nenin 1 të marrëveshjes? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është dakord me nenin 2 të marrëveshjes? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të marrëveshjes.

Kush është dakord në tërësi me marrëveshjen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë më, 22.10.2018, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit European për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit, për vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europol-it”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia. Luan Duzha, Luan Harusha, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Elona Hoxha, Anduel Xhindi dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Paulin Sterkaj, Myslym Murrizi, Ervin Salianji, Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunksi dhe Isuf Çelaj.

Të ftuar :

Rovena Voda - Zëvendësministre e Brendshme

Besfort Lamallari - Zëvendësministër i Brendshëm

Xhevahir Karaj - Drejtues i Parë, Drejtor i Drejtorisë së Kufirit, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin,

Kryekomisar Shkëlzen Rexhepi - Shef i Zyrës Kombëtare të EUROPOL-it

Anisa Boçi - Specialiste në Drejtorinë Juridike, pranë Departamentit për Shërbimet Mbështetëse.

Jeton Xoxa - Specialist i Sektorit të Bashkëpunimit, Marrëveshjeve dhe Kontratave në
Ministrinë e Brendshme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj - Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës. Dua t'ia jap fjalën zotit Besford Lamanllari, për të na prezantuar marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së për vendosjen e oficerit ndërlidhës së Europolit.

Urdhëroni, zoti Lamallari!

Besfort Lamallari – Faleminderit, zonja kryetare!

Përsëritet, të nderuar deputetë!

Ky projektakt që paraqitet sot për miratim në këtë komision është iniciuar nga Europol, është një nismë shumë e rëndësishme e parë edhe në këndvështrimin e asaj çfarë kemi kaluar disa ditë më parë, marrëveshjes së amenduar mes Shqipërisë dhe Europolit, e cila shton fushat e bashkëpunimit operacional dhe strategjik.

Vendosja e oficerit ndërlidhës në Tiranë, Shqipëri, do të jetë një shtysë më tej në luftën kundër krimit të organizuar përmes shkëmbimit të informacioneve, lehtësimit të kontakteve mes Shqipërisë dhe Europolit, por jo vetëm, duke përfshirë edhe kontaktet me pikat kombëtare të kontakteve të vendeve anëtare të BE-së.

Mendoj se kjo nismë është tejet e rëndësishme, jo vetëm për faktin se jo i gjithë rajoni do të ketë oficerë ndërlidhës, pra Shqipëria është një ndër këto vende të pakta që do të kenë, por edhe për arsye të intensifikimit konkret të bashkëpunimit mes vendeve dhe mesazhit politik që vendosja e këtij eksperti sjell bashkë me frytet e punës së përbashkët.

Kemi parë kohët e fundit që qeveria shqiptare ka bërë një sërë nismash kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda dhe ardhja e këtij eksperti është në përputhje të plotë me vullnetin e qeverisë shqiptare për luftë pa kompromis, pa ngjyrim, pa asnjë dallim ndaj krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Mendoj se është një nismë shumë e rëndësishme, e cila pritët të implementohet sa më shpejt të jetë e mundur edhe nga ana e aeroportit.

Janë trajtuar dhe zgjidhur çështjet për sa i përket imuniteteve, privilegjeve dhe përjashtimit nga detyrimet doganore etj., eksperti do të vendoset në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila bart edhe detyrimet për gjetjen e zyrës, akomodimit e të tjera.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – A ka diçka tjetër për të shtuar nga përfaqësuesit e ministrisë? S'ka.

Atëherë, ju lutem zoti Qefalia, si relator i këtij projektligji.

Xhemal Qefalia - Faleminderit!

Unë do të mundohem të jem sa më preciz, pasi zëvendësministri e trajtoi shumë saktë. Më 31.07.2018, nga drejtori i Policisë së Shtetit dhe nga zëvendësdrejtori ekzekutiv i operacioneve në Europol është nënshkruar një marrëveshje, e cila ka për qëllim vendosjen e një oficeri kontakti, me zyrë në Tiranë. Vendosja e këtij oficeri ka për qëllim të rrisë bashkëpunimin europian për zbatimin e ligjit të Europolit në vendin tonë dhe do të ketë një akses më të shpejtë dhe teknik, për të pasur akses të drejtpërdrejtë në të gjitha të dhënat e grumbulluara. Vendosja e këtij oficeri në vendin tonë, konkretisht në Zyrën Kombëtare të Europolit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit synon që të sjellë mbështetje, bashkërendim të veprimeve dhe bashkëpunim për parandalimin e luftës për krimin e organizuar, terrorizmin dhe format e tjera të krimit ndërkombëtar, si edhe lehtësimin e bashkëpunimit të informacionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Europolit dhe shteteve të tjera që aderojnë në Bashkimin Europian.

Në këtë marrëveshje është parashikuar që oficeri duhet të respektojë rregullat e sigurisë së shtetit shqiptar në masën, e cila është e zbatueshme në lidhje me praninë e tij në selinë qendrore, pavarësisht regjimit të sigurisë së Europolit, i zbatueshëm në veçanti për përpunimin e informacionit.

Shpenzimet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të planifikohet dhe do të mbulohet nga programi buxhetor i Policisë së Shtetit.

Kjo marrëveshje ka rreth 9 nene dhe përfshin kryesisht këto që thashë. Nisur nga ato që tha zëvendësministri dhe nga ato që përmenda, ftoj të gjithë kolegët e Komisionit për Sigurinë ta miratojmë këtë marrëveshje, pasi ajo do të ndihmojë në luftën ndaj terrorizmit apo në luftën ndaj krimit në tërësi.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Qefalia!

Është e qartë se është një marrëveshje jashtëzakonisht me shumë interes për vendin tonë. Ne kemi nisur një bashkëpunim me Europolin që nga 9 dhjetori i vitit 2013 dhe sot arrijmë në një marrëveshje të tillë për vendosjen e një oficeri kontakti në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, i cili do të mbajë lidhjet me Europolin që tregon qartësisht për të gjithë punën e mirë që është bërë në Policinë e Shtetit dhe për performancën e mirë, ndryshe Policia e Shtetit shqiptar nuk mund të ishte një organ i besueshëm edhe për organet ndërkombëtare

ligjzbatuese sikundër është Europol. Megjithatë në këtë pikë do të doja t'ua kaloja fjalën kolegëve nëse kanë pyetje për marrëveshjen.

Po, zoti Ndreu.

Pjerin Ndreu - Ky oficeri i kontaktit do të jetë në Shqipëri, po atje kemi të tillë, pra në Europol?

Ermonela Felaj - Po, zoti Lamallari.

Besfort Lamallari – Zoti deputet, ju falënderoj për pyetjen!

Në fakt, ne kemi një oficer kontakti në Europol, është në Hagë, i vendosur në selinë e Europolit prej disa kohësh.

Ermonela Felaj - Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea - Zoti zëvendësministër, kam një pyetje në lidhje me komunikimin ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Europolit. Dihet që janë në bashkëpunim dhe shkëmbejnë informacione, afërsisht sa mund të jenë informacionet që shkëmbehen, për shembull në muaj, patjetër, nëse është edhe bashkëpunimi për operacione të përbashkëta?

Ermonela Felaj - Po, zoti Lamallari.

Besfort Lamallari- Zonja deputete, ju falënderoj për pyetjen!

Bashkëpunimi operacional me Europolin ka ardhur gjithmonë në ngritje, sidomos vitin e fundit është mbi 15% shkëmbimi i informacioneve në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nuk kam një shifër të saktë, sepse më duhet të kisha marrë analizën 9-mujore paraprakisht që t'i referohesha kësaj pyetje, por shifrën për rritjen e sasisë së informacioneve e kam të qartë, sepse e mbaj mend, ishte 15 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, për nëntëmuorin.

Gjithashtu, është rritur bashkëpunimi operacional nëpërmjet ditëve të përbashkëta të veprimit me strukturat e Europolit, gjë që inicohet gjithnjë nga Europol, ndërsa policia shqiptare ftohet rregullisht për të marrë pjesë. Ne kemi marrë pjesë në të gjitha takimet operationale të zhvilluara nga Europol, të cilat kanë ardhur gjithmonë në ngritje.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka pyetje të tjera nga kolegët.

Kalojmë në votimin e kësaj projektmarëveshjeje.

Kush është dakord në parim me përmbajtjen e projektmarëveshjes? Faleminderit!

Kundër? Abstenime? Nuk ka.

Miratohet!

Kalojmë në miratimin e nenit 1 të projekt marrëveshjes.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Abstenime? Nuk ka.

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 2, i cili bën fjalë për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje?

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet!

Kalojmë në miratimin në tërësi të marrëveshjes.

Kush është dakord me marrëveshjen me Europolin, për vendosjen e hapësirës së kontaktit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit?

Nuk ka kundër. Miratohet edhe kjo marrëveshje.

Faleminderit, zotit Lamallari dhe përfaqësuesve të tjerë të Ministrisë së Brendshme, për prezencën!

Punë të mbarë!

Anëtarëve të komisionit do t'u lutesha të qëndronin vetëm një minutë, që të komunikojmë në lidhje me ditën e nesërme.

Kolegë,

Për nesër kemi parashikuar të nisemi në orën 11. 30. Në fakt, njoftimi është bërë për në orën 10, por na duhet ta spostojmë, për shkak se në Shqipëri vjen ministrja e Mbrojtjes së Italisë. Në orën 10: 30 ajo do të jetë në një takim me Kryeministrin. Në orën 11:30, ne kemi planifikuar të nisemi për të vizituar Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare, QNOD-në. Ju lutem, merrni masa për të kontaktuar edhe me stafin, se cili nga kolegët do të jetë. Unë gjykoj se është mirë të jemi të gjithë, për faktin se kalendari ynë i ardhshëm i vizitave në pikat e kalimit kufitar, ato që do të jenë në Muriqan dhe në Tivat, është i lidhur ngushtë edhe me këtë vizitë që po bëjmë te QNOD-ja.

Kësisoj, për çdo çështje mund të komunikoni me stafin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – A mund të bëj një sugjerim, kryetare?

Ermonela Felaj – Po.

Vullnet Sinaj – Është mirë që herë tjetër, këto takimet t'i bëjmë përpara se të diskutojmë për ligjet këtu, në komision. Ne po shkojmë te Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare,

ndërkohë që e kemi diskutuar dhe e kemi kaluar atë në komision. Do të shkojmë në Muriqan në atë pikën tjetër kufitare, pasi e kaluam sot në komision ndërtimin e pikës së re kufitare. Mbase u paraprijmë në të ardhmen.

Ermonela Felaj – Është edhe çështje e kalendarit të Kuvendit, në fakt. Megjithatë, ndërhyrja është e drejtë. Unë besoj se me këtë vizitë po i paraprijmë vizitës që mendojmë të bëjmë në Tivat me OSBE-në.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne do të nisemi në 11.30 nga Kryesia e Kuvendit. Besoj se në 12 do të jemi atje.

MBYLLET MBLEDHJA